



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

**Legjislatura VI**

Sesioni pranveror

Komisioni për Legjislacion, Mandate,

Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen

e Agjencisë Kundër Korrupsionit

Mbledhja nr. 39

Prishtinë, më 23.10.2018, në orën 13:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N/204

**PROCESVERBAL**

**Në mbledhje morën pjesë:** Albulena Haxhiu, Hajdar Beqa, Bahrim Shabani, Frashër Krasniqi, Sami Kurteshi, Arben Gashi, Korab Sejdiu, Igor Simiç, Shkumbin Demaliaj dhe Bilall Sherifi.

**Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë:** Shaban Murturi, Blerta Bejtullahu dhe Edita Kusari, EUO/EUSR; Rrahman Ramaj, BIRN; Erblina Sejdiu, praktikante-Kuvend; Besiana Bajrami, EO; Ardina Hajra, NGOAKTIV; Lavdim Krasniqi, SKPK; Bahri Hyseni, KPK; Petroviq Verlplub, HCM; Nehat Idrizi, Vahid Limani dhe Muhamet Kurtishaj, KGJK; Melodika Abrashi, KDI; Sanije Berisha, OSCE.

**Mbledhjen e kryesoi,** Albulena Haxhiu, kryetare e Komisionit

**Rendi i ditës:**

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më 18.7.2018;
3. Shqyrtimi i kërkesave të Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe Këshillit Prokurorial të Kosovës lidhur me Projektligjin për Pagat dhe Zyrtarët Publikë;
4. Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr. 06/L-101 për të Drejtën Ndërkombëtare Private;
5. Të ndryshme.

**1. Miratimi i rendit të ditës;**

*Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.*

## **1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më 18.7.2018;**

*Kryetarja konstatoi procesverbali nga mbledhja e mbajtur më 18.7.2018, u miratua pa vërejtje.*

## **2. Shqyrtimi i kërkesave të Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe Këshillit Prokurorial të Kosovës lidhur me Projektligjin për Pagat dhe Zyrtarët Publikë;**

**Albulena Haxhiu, kryetare,** tha se në lidhje me kërkesat e Këshillit Gjyqësor dhe Prokurorial për Projektligjin për pagat, të ftuar në mbledhje janë përfaqësuesit e këtyre institucioneve të cilët edhe do t'i arsyetojnë këto kërkesa para komisionit.

Para anëtarëve të Komisionit kërkesat e Këshillit Gjyqësor në lidhje me projektligjin për pagat, i paraqiti kryesuesi i Këshillit Gjyqësor z. Nehat Idrizi. Ai tha se kërkojnë trajtim të barabartë të tri pushteteve, duke iu referuar nenit 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, ku garantohej një barazi e tillë. Ndërsa prokurori Bahri Hyseni, tha se është bërë shkelje kushtetuese sepse nuk është respektuar parimi i ndarjes së barazisë së pushteteve. Kërkojnë status të veçantë kur dihet se edhe në përshkrim të detyrave, kjo kategori ka specifika të veçanta e që i bëjnë të dallohen sidomos nga disa kategori të punonjësve të shërbimit civil.

Pas diskutimeve që pati nga deputetët dhe përfaqësuesit e institucioneve, kryetarja konstatoi se Komisioni nxori këtë:

### **P Ë R F U N D I M**

1. Komisioni, përkrahë, kërkesat dhe propozimet e paraqitura nga Këshilli Prokurorial dhe Këshilli Gjyqësor i Kosovës, në lidhje me Projektligjin për Pagat në Sektorin Publik, sipas të cilave caktimi i pagave duhet të bëhet duke respektuar parimin kushtetues të ndarjes dhe barazisë së pushteteve, parim ky i cili nuk është respektuar në këtë projektligj.
2. Komisioni, i rekomandon Komisionit FunkSIONAL për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media, që gjatë shqyrtimit dhe amendamentimit të këtij Projektligji, të përkrahen kërkesat e Këshillit Prokurorial dhe Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe pagat e degës së gjyqësorit të jenë ekuivalente me dy degët tjera të pushtetit.
3. Komisioni ka caktuar dy anëtarë të tij, deputetët: Shkumbin Demaliaj dhe Sami Kurteshi, që të marrin pjesë në mbledhjet e Komisionit FunkSIONAL dhe të kontribuojnë gjatë shqyrtimit të këtij projektligji, në lidhje me këtë çështje.
4. **Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr. 06/L-101 për të Drejtën Ndërkombëtare Private;**

**Kryetarja,** tha se ky projektligj rregullon marrëdhëniet juridiko-private me elementë të huaj në lidhje me zbatimin e së drejtës, juridiksionit apo të drejtën procedurale ndërkombëtare si dhe njohjen e ekzekutimeve të vendimeve. Ajo tha se sipas një analize që ka bërë për këtë projektligj, ka vërejtje në disa pika: projektligji nuk përmban një dispozitë të caktuar në lidhje me

parashkrimin, vërejtja tjetër ka të bëjë me fejesën, pra duhet të theksohet se cila e drejtë duhet të zbatohet në lidhje me prishjen e fejesës sepse kjo nuk specifikohet, mungon forma shkallore e përcaktimit të zbatimit të së drejtës në lidhje me shumë kategori juridike, vërejtja tjetër është ajo në nenin 52, që ka të bëjë me adoptimin. Problem tjetër në këtë projektligj, sipas deputetes është edhe ekzekutimi i vendimeve të huaja në gjykata vendore, nuk është përfshirë parimi i reciprocitetit etj. Haxhiu shtoi, se këto çështje duhet patjetër të procedohen, dhe në qoftë se në shqyrtimin e dytë nuk përfshihen, atëherë natyrisht që në shqyrtimin e dytë nuk e përkrahim, por megjithatë, do ta përkrahim në parim, theksoi Haxhiu.

**Sami Kurteshi**, tha se konsideron që ky projektligj është jashtëzakonisht i rëndësishëm, por është i vonuar. Sipas Kurteshit, ky ligj e fut Kosovën në mesin e vendeve demokratike, ku fillimet të pranohet jo vetëm politikisht Kosova, por edhe përmes vendimeve gjyqësore. Ai tha se duhet plotësuar ky projektligj në leximin e dytë dhe theksoi se do ta përkrahë projektligjin me vërejtjet e paraqitura nga deputetja Albulena Haxhiu.

**Hajdar Beqa**, tha se ky projektligj është më se i domosdoshëm në sistemin legjislativ të Kosovës. Meqenëse ky ligj është i një rëndësie të veçantë, konsideroj se duhet ekspertizë më e madhe, pra duhet të angazhohen ekspertë të ndryshëm, që të ndihmojnë grupin punues, në mënyrë që ky ligj të jetë i nivelit më të mirë dhe se do ta përkrahë projektligjin në këtë fazë.

**Shkumbin Demaliaj**, tha se e përkrahë propozimin e deputetit Beqa, që të angazhohen ekspertë për këtë projektligj, në mënyrë që të mos ketë kolizion në mes ligjeve dhe se përkrahja është e domosdoshme për këtë projektligj.

Pas diskutimeve komisioni nxori këtë:

## **R e k o m a n d i m**

Të miratohet, në parim, Projektligji nr.06/L-101 për të Drejtën Ndërkombëtare Private .

### **5. Të ndryshme.**

**Bilall Sherifi**, paraqiti kërkesën e sindikatës së Qendrës së Paraburgimit në Pejë, në mënyrë që komisioni të shqyrtojë edhe njëherë kërkesat e tyre drejtuar Komisionit për Legjislacion.

**Kryetarja**, theksoi se kërkesat e Sindikatës së Qendrës së Paraburgimit në Pejë, janë adresuar në komisionin përkatës dhe janë proceduar. Megjithatë, në mbledhjen e ardhshme të Komisionit, do të jenë edhe ata të ftuar ku do të paraqesin vërejtjet e tyre në lidhje me Ligjin për Pagat.

Mbledhja përfundoi në orën 14:10

E përgatiti:

Stafi Mbështetës i Komisionit.

Kryetarja e Komisionit,  
**Albulena Haxhiu**